



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Kapitulli 1

KUPTIMI DHE KLASIFIKIMI I TREGJEVE FINANCIARE

Ph.D. Fisnik Morina



TREGJET DHE INSTITUCIONET FINANCIARE



- Lënda: Tregjet dhe Institucionet Financiare
- Viti II-të, Semestri IV, Departamenti: Administrim Biznesi
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Mësimdhënesit: Prof. Asoc. Dr. Halil Kukaj
Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: halilkukaj@yahoo.com
fisnik.morina@unhz.eu





PresenterMedia

Kuptimi dhe klasifikimi i tregjeve



PresenterMedia

- **Tregjet** përfaqsojnë hapësirat fizike ose funksionale të kryerjës së veprimeve të shkëmbimit të mallrave, të shërbimeve, të parave dhe të letrave të ndryshme me vlerë, me anën e mekanizimit dhe instrumenteve të posaqme dhe me pjesëmarrjen e institucioneve e të individëve të caktuar.
- Nga ana gjeografike mund të dallohen: në tregje lokale, kombëtare, ndërkombëtare dhe botërore.
- Në **tregjet lokale** kryhen shkëmbimet me pjesëmarrjen e institucioneve dhe të individëve të një qyteti ose të një rajoni, ndërsa në **tregjet kombëtare** kryhen shkëmbimet me pjesëmarrjen e institucioneve dhe të individëve nga gjithë vendi për mallrat, shërbimet, paratë dhe të letrave me vlerë të prodhuara ose të importuara prej tij.



PresenterMedia

Kuptimi dhe klasifikimi i tregjeve



PresenterMedia

- Në **tregjet ndërkombëtare** kryhen shkëmbime me pjesëmarrjen e institucioneve dhe të individëve nga vende të ndryshme të një rajoni ose kontinenti.
- Kurse, në **tregjet botërore** kryhen shkëmbime me pjesëmarrjen e institucioneve dhe të individëve nga e gjithë bota.
- Veprimet e shkëmbimit mund të kryhen si me pjesëmarrjen fizike direkte të institucioneve e të individëve, ashtu edhe nëpërmjet komunikimit elektronik ndërmjet tyre.



PresenterMedia

Kuptimi dhe klasifikimi i tregjeve



PresenterMedia

- Sipas nivelit të shkëmbimit të mallrave dhe llojeve të ndryshme të letrave me vlerë tregjet dallohen në tregje primare dhe tregje sekondare.
- Në **tregjet primare** realizohen ato shkëmbime që sigurojnë mallrat me shumicë dhe fonde financiare nëpërmjet emetimit të letrave të reja me vlerë.
- Në **tregjet sekondare** kryhen shkëmbimet që lidhen me rishitjen dhe riblerjen e atyre mallrave, shërbimeve dhe instrumenteve financiarë të emetuara e të tregtuara më parë në tregjeve primare.



Kuptimi dhe klasifikimi i tregjeve



- Nga pikëpamja e mënyres së kryerjës së shkëmbimeve dhe e likuidimit të tyre tregjet dallohen në:
 - a) Tregje me dorëzim dhe likudim të përnjehershëm të objekteve të shkëmbyera që në gjuhen ndërkombëtare njihen si tregje spot dhe
 - b) Në tregje me dorëzim dhe likuidim të ardhshëm të objekteve të shkëmbyera që në gjuhen ndërkombëtare njihen si tregje me zbatim të ardhshëm të kontratave të tregtimit.



Kuptimi dhe klasifikimi i tregjeve



- Në **tregjet spot** nënshkrimi i kontratave të shkëmbimit shoqërohet me kalimin e përnjehershëm fizik të objektit dhe të pronësisë nga shitësi te blerësi dhe likuidimin e menjëhershëm e të plotë të vlerës së tij nga blerësi.
- Në **tregjet me dorëzim të ardhshëm** momenti i nënshkrimit të kontratës së tregtimit të mallrave ose të letrave me vlerë nuk shoqërohet me kalim të menjëhershëm të objektit nga shitesi tek blerësi dhe me likuidimin e menjëhershëm të vlerës së tij nga blerësi, por të dyja këto momente parashikohen për një datë të ardhshme.



PresenterMedia

Kuptimi dhe klasifikimi i tregjeve



PresenterMedia

- Tregjet mund të dallohen edhe nga numri i blerësve dhe i shitësve pjesëmarrës në shkëmbimet e llojeve të ndryshme të mallrave, shërbimeve dhe letrave me vlerë.
- Në qoftë se në shkëmbimet e një tregu marrin pjesë shumë shitësa dhe shumë blerësa, atëherë në treg mund të zhvillohet një konkurrencë e lirë dhe e plotë, me një ndikim pozitiv si në procesin e formimit të çmimeve, ashtu dhe në efektivitetin e ekonomisë.



PresenterMedia

Kuptimi dhe klasifikimi i tregjeve



PresenterMedia

- Në qoftë se në shkëmbimet e një tregu merr pjesë një shitës ose një numër i vogël i shitësve dhe një numër i madh i blerësve, atëherë themi se në treg sundon monopoli ose oligopoli, prandaj nuk mund të kemi konkurrencë të lirë dhe formimi i çmimeve bëhet në favor të shitësit e në dëm të blerësit me pasoja negative në efektivitetin e ekonomisë.
- Sot në kushtet e globalizimit të ekonomisë dhe të tregjeve ka një përafrim të madh të legjislacionit që rregullon funksionimin dhe mbikqyrjen e tregjeve, themelimin dhe funksionimin e institucioneve financiare që marrin pjesë në to si dhe përmbajtjen e instrumenteve të ndryshme financiare që përdoren në këto tregje financiare.



Kuptimi dhe klasifikimi i tregjeve



- Trajtimi i tregjeve financiare, i instrumenteve dhe i veprimeve të tyre bëhet duke u nisur në radhë të parë nga legjislacioni dhe praktika e SHBA-ve, për tre arsye kryesore:
- **Së pari** në këtë vend sistemi, legjislacioni dhe praktika më e përparuar e tregjeve financiare nga mund të marrin eksperiencë shumë vende të tjera.
- **Së dyti**, sepse nga pikëpamja e vëllimit, veprimet e tregjeve financiare në SHBA kanë një ndikim shumë të madh në të gjitha tregjet e tjera të botës.
- **Së treti**, studimi i legjislacionit dhe i praktikës të tregjeve të SHBA-ve dhe krahasimet përkatëse mund të ndihmojnë shumë edhe në përmisimin e tregjeve financiare të vendit tonë.



Karakteristikat e tregjeve financiare dhe instrumenteve të tyre



- **Tregjet financiare** përfaqsojnë tërësinë e strukturave institucionale të cilat nëpërmjet përdorimit të instrumentave të posaqme financiare sigurojnë mobilizimin e fondeve të lira të popullësisë dhe të njësive ekonomike për plotësimin e nevojave huamarrëse të qeverive, të njësive të tjera ekonomike dhe të individëve.
- Tregjet financiare ndahen në katër grupe kryesore që janë:
 1. **Tregjet monetare**
 2. **Tregjet e kapitaleve**
 3. **Tregjet valutore dhe**
 4. **Tregjet e derivateve financiare**



Karakteristikat e tregjeve financiare dhe instrumenteve të tyre



- **Tregjet monetare** përfaqsojnë ato struktura institucionale, të cilat me anën e instrumentëve të posaçme financiarë mobilizojnë për një afat deri në një vit fondet e lira monetare të popullësisë dhe të njësive ekonomike dhe i vënë ato si fonde të huazuara në dispozicion të qeverive, të njësive ekonomike dhe të individëve të veçantë.
- Mobilizimi dhe huazimi afatshkurtër i fondeve të lira në tregjet monetare realizohet me anën e instrumentëve financiar që vijojnë:
 1. Kambialeve ose bonove të thesari
 2. Fondeve monetare të bankave qendrore
 3. Marrëveshjet e riblerjës të letrave me vlerë
 4. Kambialet tregtare
 5. Çertifikatat e tregtueshme të depozitave me afat dhe
 6. Premtim pagesat ose letër kredite tregtare.



Karakteristikat e tregjeve financiare dhe instrumenteve të tyre



- **Tregjet e kapitaleve** përfaqsojnë strukturat institucionale dhe instrumentet e veçanta që përdoren për mobilizimin afatgjatë të fondeve të lira të popullësisë dhe të njesive ekonomike për t'ua huazuar ato për një mbi një vit qeverive, njesive ekonomike dhe individëve që kanë nevojë për fonde suplementare afatgjata për zgjerimin e veprimtarisë së tyre.
- Instrumentet financiarë që përdoren në tregjet kapitale janë:
 - a) Aksionet e njësive ekonomike
 - b) Obligacionet shtetërore
 - c) Obligacionet private të njesive të ndryshme ekonomike dhe
 - d) Titujt e hipotekave dhe letrat me vlerë e tregtimit të huave ose të borxheve.



Karakteristikat e tregjeve financiare dhe instrumenteve të tyre



- Një rol të madh në tregjet financiare luajnë **tregjet valutore**.
- Në këto tregje realizohen me një kurs të caktuar të gjitha llojet e këmbimeve ndërmjet monedhave të ndryshme kombëtare të cilat lidhen me import – eksportin e mallrave, të letrave me vlerë dhe të kapitaleve të ndryshme, përfshirë edhe kapitalet spekulativë.
- Në **tregjet e derivateve financiare** kryhen veprimet e tregtimit të disa letrave me vlerë të prejardhura nga letrat e tjera primare me vlerë (siç janë aksionet, obligacionet, valutat ose normat e interesit) ose nga disa mallra të caktuara.
- Këto derivate financiare përdoren për përballimin e rreziqeve që vijnë nga luhatja e madhe e çmimeve të aksioneve, të mallrave, të kurseve të këmbimit të valutave dhe e nivelit të normave të interesit.

Ju Faleminderit për vëmendje !

□ SUKSESE !

